



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

16.07.2024

Drejtuar: BOE CLIMACASA shpk & JUNIK shpk

Adresë: CLIMACASA shpk Lagjia Beselidhja, Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, Kati per dhe

JUNIK shpk Lagjia SMT, Ndërtesë 2 Katëshe, Kati 2, Pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Lezhë

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur, mbi Kufrin e Larte Monetar

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-07142-05-29-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Riparim mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja, sistemeve të ngrohjes-ftohjes me chillera, të stacionit qendror të pompave dhe sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, të elektropomave, në godinat e shërbimeve spitalore në QSUNT". Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Fondi limit : 61,053,111.63 (gjashtëdhjetë e një milion e pesëdhjetë e tre mije e njëqind e njëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 29 datë 03.06.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE "CLIMACASA shpk & JUNIK" shpk

Emri i plotë i shoqërisë

L07805502F & J68007522L

Numri i NIPT-t

Vlera 45,790,560 (dyzet e pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh

2. “BEST-TECH AL 2000” shpk

L81625005U

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 47,968,280 (dyzet e shtatë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh

3. “KLIMATEKNIKA TB92” shpk

K49322506W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 51,825,687 (pesëdhjetë e një milion e tetëqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

4. BOE “ALTEC & B93 II” shpk

K57923807W & L52209050O

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 51,900,347.60 (pesëdhjetë e një milion e nëntëqind mijë e treqind e dyzet e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh

5. “AIDA CONSTRUCTION” shpk

M03116403L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 59,253,270 (pesëdhjetë e nëntë milion e dyqind pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh

6. “SULLOLLARI-KLIMA” shpk

K01529003M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 39,901,797 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1) “AIDA CONSTRUCTION” SH.P.K

M03116403L

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 59,253,270 (pesëdhjetë e nëntë milion e dyqind e pesëdhjetë e tre e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet e mëposhtëme:

1. Operatori Ekonomik nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas shtojcës 8 të DST, sipas pikës 1 të Seksionit 2.1 “Kapaciteti Teknik” në lidhje me furnizimet e mëparëshme, pasi në tre vitet e fundit rezulton se nuk ka kryer punë të ngjashme me punimet e mirembajtjes dhe shërbimeve të sistemeve të ngrohjes -ftohjes, si në përmbajtjen e zërave të kërkuar (shërbime të mirëmbajtjes të sistemeve të kondicionimit të mirembajtjes të sistemeve kaldaje me, apo te pompave të sistemeve të furnizimit me ujë) uje ashtu edhe në vlerat e realizuara, konkretisht ky operator ka paraqitur

I)Kontrate dt.25.10.2021 me Bashkinë Korçë “Montim kaladaje me djegës +linjë furnizimi me vlerë **9,447,223 lekë pa TVSH**.

II).Kontratë Nr.17608/8 dt.16.11.2022 me Ministrinë e Financave “Rikonstruksion Hoteleri turizëm, Tiranë” me vlerë 32,297 547 me TVSH, realizuar në bashkëpunim me subjektin 6 D Plan me ndarje të kontrubuteve 90% +10%. Kjo kontratë ka disa zëra punimesh si punime mekanike në vlerën 1,225,000 lekë pa TVSH , ku subjekti AIDA CONSTRUCTION ka realizuar **1,102,500 lekë pa TVSH** .

III) Kontratë Sipermarrje me personin fizik Ergyn Geci me Nr.36 dt 01.06.2022 “Ndertim panele fotovolatike për përdorim vetjak”, me vlerë 9,962,787 lekë e cila **nuk ka asnjë zë punimesh të punimesh të ngjashme me kontratën e shpallur nga Autoriteti Kontraktor.**

IV)Kontratë Nr.2683/30 dt.04.04.2022 “Rikonstruksion i ambienteve të qendrës shëndetsore Ruzhdie dhe ambulancës në Dukas Coban.” Me vlerë 11,973,509 lekë pa TVSH ku evidentohen disa zëra të ngjashëm në systemin eujit dhe ngrohjes me vlerë **365,095 mijë lekë pa TVSH**.

V)Kontratë me bashkinë Patos “Rikonstruksion i magazinës “Gani Banaj” me funksion shërbime artizanale” Nr. 542/16 dt28.05.2021, realizuar si BOE me subjektin Ed Konstruksion në raportin 81% me 19% , ku janë evidentuar punime të ngjashme :

-Rrjeti i ujit me vlerë 152,731 lekë pa TVSH

-Punime mekanike me vlerë 1,80,944 leke pa TVSH

-punime per kaldajën në vlerën 2,050,000 lekë pa TVSH

Referuar % së kontratës së bashkëpunimit subjekti AIDA CONSTRUCTION rezulton se ka kryer rreth **3,500,000 lekë pa TVSH**.

VI) Kontratë Punimesh me subjektin privat “Ed Konstruksion” sh.p.k, me objekt “Punime rifiniture , elektrike, hidraulike dhe ndërtim të Godinës multifunksionale 4 kate-Divjake” e cila është paraqur ne forme teparregullt pasi nuk shoqerohet me akt-kolaudim te punimeve te kryera nuk ka certificate te marrjes ne dorezim te punimeve si dhe fatura tatimore elektronike e paraqitur është e pavlefshme pasi rezulton e papranuar ne sistemin tatimor. Në konkluzion subjekti AIDA KONSTRUCTION nuk përmbush objektin e punimeve te ngjashme te realizuar si dhe nuk plotëson vlerën e kërkuar ku ka realizuar rreth **14,414,000 lekë pa TVSh** nga 39% e FL(=23,800,000 leke pa TVSH) që është vlera e kërkuar në DST.

2.“SULLOLLARI-KLIMA”SH.P.K

Emri i plotë i shoqërisë

K01529003M

numri i NIPT-it

Vlera: 39,901,797 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, për arsyet e mëposhtëme:

-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e ligjit nr.162/2020, në lidhje me argumentimin e kërkesave kumulative të përcaktuara në Nenit 93 të LPP dhe njoftimin e Autoritetit Kontraktor drejtuar në SPE e konkretisht *a) argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar; dhe c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*

Në shkresën e paraqitur me Lëndë ”SHPJEGIME/SQARIME” operatori ekonomik ka paraqitur ne forme narrative shpjegime kryesisht për koston e mallrave dhe kostove të punës(oret e punes) që ka llogaritur për realizimin e shërbimit. Operatori nuk arriti te argumentojë ofetën anomalisht të ulët, pasi shkresa e paraqitur përmban kryesisht deklarime të OE dhe nuk shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe ekonomik provues për çështje thelbësore të argumentimit të cmimit të ofertës.

Referuar kushteve e percaktuara ne Nenin 93 te LPP, operatori ekonomik ka patur detyrimin të argumentojë ofertën duke sqaruar cdo element të përcaktuar nga kjo dispozite e ligjit e konkretisht për:

- a) argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Referuar praktikës së vlerësimit të Komisionit të Prokurimit Publik dhe dispozitës ligjore nenit 93 të LPP, argumentimi ikushteve të mësipërme duhet të kryhet në mënyrë kumulative ku mosargumentimi qoftë edhe i një kërkesë përbën mosplotësim të kërkeave për argumentimin e ofertës anomlaisht të ulët.

1.Arsyetimi për mosargumentimin e kushtit:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtim/argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar;

Në lidhje me këtë kërkesë të ligjit mbi argumentimin e ofertës anomlaisht të ulët, Operatori Ekonomik shprehet se cmimet i mbështet në ofertat e tregut, faturat tatimore të shitjes dhe materialeve të blera më parë, të cilat sipas saj i disponon në magazinat e shoqërisë. Gjithashtu në lidhje me kostot në cmimin e ofertës operatori ekonomik ka deklaruar se ka kryer analize të cmimeve të orëve të punës të kërkuara në preventiv sipas DST, referuar të gjitha kategorive të shërbimeve duke vendosur një kosto prej 270 lekë/orë pune dhe 300 lekë/orë pune, vlerë e cila është sipas operatorit me pagën e deklaruar sipas listëpagesave të subjektit në koston prej 208,1 lekë/ore pune.

Në lidhje me mangësitë dhe mungesën e argumentimit të cmimit të ofertës të subjektit, KVO vlerëson se :

Se pari,

Argumentimi i cmimit të materialeve dhe pajisjeve ,mbështetur në faturat tatimore të shitjes nuk është i rregullt. Një pjesë e fatuare të paraqitura janë viteve të 2021 , 2022 dhe 2023 dhe fillimi i viti 2024, dhe këto dokumente nuk reflektojnë situatën koherente të cmimeve të tregut për këto produkte. Këto fatura tregojnë se operatori ekonomik ka realizuar blerje për zëra të ngjashme me zërat në preventivine ofertës, por ato nuk janë cmime të siguruara për këtë kontratë por pjanë kryesisht realizuar për kontratat të tjera për të cilat operatori kryen aktivitetin e vet. Për sigurimin e materialeve/pajisjeve për këtë objekt prokurimi “Mirëmbajtja e sistemeve ngrohje -ftohje sistemeve të ujit dhe kaldajave të QSUNT”, operatori duhet të paraqiste oferta të dedikuara nga distributorë të autorizuar që tregojnë çfarë produktesh kanë të drejtë të tregtojnë këta furnizues dhe për cilët prodhues .

Konkretisht faturat tatimore Nr. 310/15.02.2022 ,Fatura Nr.280/23.03.2023, Fatura Nr.104 dt.22.03.2023, Fatura Nr.1343/01.12.2023, Fatura Nr.40/18.01.2023, Fatura 46/26.01.2024 Fatura Nr.688/ 01.04.2021, Fatura Nr.310/15.02.2022, Fatura Nr.6/06.01.2023, Fatura Nr.4142/10.02.2023. Fatura Nr.113/23.12.2023 Fatura 26/13.07.2019, fatura 2119/15.11.2022.Gjithashtu ofertat e siguruara nga operatorët ekonomik ALTECH sh.p.k,

dt.17.06.2024, BEST TECH AL sh.p.k dt.10.06.2024, Dritan Xhaferri p.f dt.14.06.2024 dhe Luljeta Nasufi p.f 18.06.202, 4 nuk shoqërohen me asnjë dokument provues se për cilat tipe marka tregtare këta të fundit kanë të drejta tregtimi/janë distributorë të autorizuar të produkteve që do të furnizojnë, duke mos argumentuar dhe provuar deklaratimet e veta.

Së dyti,

operatori ekonomik pretendon se disponon gjendje në magazinat e veta, materiale, pjesë këmbimi dhe pajisje sipas zërave të preventivit por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues si “Gjendja aktuale kontabël” të materialeve e pajisjeve rezerve në magazinat e veta duke mos argumentuar dhe provuar deklaratimet e veta.

Së treti,

Mungon krejtësisht argumentimi i kostos së punës e cila zë një zë të rëndësishëm në prevetinin e kësaj oferte. Për këtë element të preventivit operatori ekonomik ka deklaruar “kosto prej 270 lekë/orë pune dhe 300 lekë/orë pune”, vlerë e cila vjen në kundërshtim me pagën e deklaruar sipas listëpagesave të subjektit në koston prej 208,1 lekë/ore pune”. Për këto deklarime operatori nuk ka paraqitur asnjë listëpagesë të subjektit SULOLLARI KLIMA , dhe asnjë listëpagesë të operatorit ERXHEN sh.p.k si subjekt mbështetës me 9 punonjës, në mënyrë që të provojë deklaratimet e veta mbi pagat e punonjesve në funksion të kostos së punës. Gjithashtu KVO konstaton se deklarimi se pagat e punonjesve sipas listëpagesave të deklaruara në organet tatimore është 201,8 lek/orëpune vjen në kundërshtim për detyimet ligjore për pagën minimale dhe koston e punës në Republikën e Shqipërisë . Për këtë element të preventivit KVO konstaton se operatori nuk ka argumentuar cmimin e ofertës pasi referuar DST për këtë objekt prokurimi, AK ka kërkuar një numër punonjësish të specializuar (4 inxhinerë, 4 elektrikistë, 4 hidraulikë dhe 8 punonjës të specializuar ngrohje-ftohje, nga të cilët 2 elektrikistë, 2 hidraulikë , 2 punonjës teknik ngrohje-ftohje dhe 1 Inxhiner mekanik janë deklaruar si punonjës të subjekti mbështetës ERXHEN sh.p.k.. Mbështetur në këto fakte KVO vlerëson se operatori nuk ka paraqitur analizë ekonomike dokumentacionin ligjor provues (listëpagesat, kontrata pune etj) për subjektin ofertues dhe as për subjektin mbështetës për llogaritjen e kostos së punës dhe analizës së deklaruar për cmimin e ofertës së punës, e për këtë arsye kjo pjesë e cmimit të ofertës nuk është e argumentuar. Gjithashtu mungesa e argumentimit të kostos së punës dhe deklarimet e kryera se pagat e punonjesve sipas listëpagesave të deklaruara në organet tatimore është 201,8 lek/orëpune, përbëjnë mospërbushje të kushti kumulativ të përcaktuar në Nenin 93 të LPP ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

2.Arsyetimi për mosargumentimin e kushtit:

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

Në lidhje me këtë kusht të ligjit mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, Operatori Ekonomik në pjesën narrative ka deklaruar se “mallrat do të jenë origjinale dhe se pjesët e këmbimit do të jenë në përputhje me pajisjet e instaluara në objekt dhe të gjitha do të përputhen me market dhe me origjinën e tyre”. Referuar shtojcës 5 të DST “Specifikimet Teknike” , ku përshkruhen hollësisht kërkesat Autoriteti Kontraktor për këtë shërbim përcaktohet se:

- Cilësia e shërbimit të kërkuar është parësore, pasi vetë natyra e shërbimit të ofruar nga Q.S.U.T është delikate dhe shumë e ndjeshme nga punimet që kryhen në çdo godinë spitalore, ku ofrohet shërbim mjekësor.

- Të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje duhet të jenë të certifikuara (CE).

Mbi kete bazë dhe deklarimeve të cituara më sipër, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi origjinalitetin e materialeve dhe pajisjeve sipas preventivit të punimeve.

Konkretisht mungojnë Certifikatat e Konformitetit CE për të gjitha materialet e ofertuara, si kusht thelbësor i vendosur nga QSUNT në njoftimin e kontratës .Për këtë pikë, operatori ekonomik deklaron se disponon Certifikatë ISO që ka lidhje me objektin e prokurimit ndërkohë që QSUNT ka kërkuar shprehimisht ne DST, Certifikim CE për pajisjet dhe materialet që do të vendosen në sistemet e saj. Gjithashtu operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi të drejtat tregtare të subjekteve furnizues për të cilat ka paraqitur fatura tatimore apo oferta, në mënyrë që të argumentonte se për cilat produkte apo marka këta të fundit janë distributorëtë autorizuar apo prodhues të matarialeve të ofertuara. Operatori Ekonomik nuk verteton me dokumente nëse produktet kanë certifikimet e nevojshme dhe subjektet kanë të drejta e nevojshme tregatre për sigurimin e furnizimit të këtyre produkteve. Operatori Ekonomik ofertues nuk ka paraqitur asnjë të dhënë se ka studiuar markat e pajisjeve dhe produketev që disponojnë sistemet e QSUNT dhe nuk ka paraqitur dokumente mbi cilësinë e produkteve të furnizuesve të vet në mënyrë që të përmbushte këtë kërkesë ligjore të argumentimit të ofertës. KVO vlerëson se mosdeklarimi i certifikimeve dhe cilësisë të produkteve cënon direkt kërkesat e cilësisë të QSUNT në cdo godinë spitale ku ofrohen shërbime mjeksore.

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të Nenit 93 pika 2 të ligjit të ligjit nr.162/2020, dhe arsyetimin e parashtruara më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se **operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e subjektit SULOLLARI KLIMA sh.p.k.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE CLIMACASA shpk & JUNIK shpk

Adresë: CLIMACASA shpk Lagjia Beselidhja, Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, Kati per dhe & JUNIK shpk Lagjia SMT, Ndërtesë 2 Katëshe, Kati 2, Pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Lezhë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 45,790,560 (dyzet e pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh/ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

